




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUĐSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës në përputhje me nenin 108 dhe 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 1, pika 1.15 dhe pika 1.23 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 2 të Ligjit Nr. 05/L – 032 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L -199 për Gjykatat, nenin 3 dhe 12 të Ligjit Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike dhe nenin 1.15 dhe 1.16 të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtje të të Dhënave Personale, miraton këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (02/2016)
PËR ANONIMIZIMIN DHE PUBLIKIMIN E AKTGJYKIMEVE TË PLOTFUQISHME

Kapitulli I
Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1.1 Ky udhëzim përcakton mënyrën e anonimizimit dhe publikimit të aktgjykimeve të plotfuqishme në ueb-faqen zyrtare në interes të qasjes publike në aktgjykimet e gjykatave për promovimin e transparencës gjyqësore.

Neni 2
Përkufizimet

- 2.1. Shprehjet e përdorur në këtë udhëzim nënkuptojnë:
- 2.1.1. “Aktgjykim i Plotfuqishëm” nënkupton përkufizimin sipas ligjeve përkatëse.
 - 2.1.2 Urdhër nënkupton konfirmimin me shkrim nga ana e gjyqtarit të çështjes për publikimin e aktgjykimit..
 - 2.1.3 “Anonimizim” nënkupton procesin e heqjes së informatave personalisht të identifikueshme apo të ndjeshme nga grupet e të dhënave, me qëllim që personat fizik të cilët përshkruhen nga të dhënat të mbesin anonim.
 - 2.1.4 “Ueb-faqe Zyrtare” do të thotë Ueb-portali gjyqësor i mirëmbajtur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

2.1.5 “Të Dhënat Personale” janë të përkufizuar në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 3 **Anonimizimi i të dhënave**

- 3.1 Aktgjykimi i Plotfuqishëm publikohet në formë të plotë.
- 3.2. Të dhënat personale në aktgjykimet e plotfuqishme penale, civile, administrative dhe ekonomike që anonimizohen janë:
- 3.2.1 Emri, mbiemri, adresa, data dhe vendi i lindjes, numri i letërnjoftimit apo pasaportës, patentë-shoferi apo tabelat e regjistrimit të automjetit, apo numri i ndonjë dokumenti tjetër personal i palës.
 - 3.2.2 Të autorizuarit e palës, siç janë përfaqësuesit ligjorë të palës, avokatët apo praktikuesit ligjorë, noterët, duke përjashtuar avokat in shtetëror.
 - 3.2.3 Administruesit falimentues dhe debitorët.
 - 3.2.4 Kreditorët ekzekutues dhe debitorët.
 - 3.2.5 Numri personal apo numri fiskal.
 - 3.2.6 Adresa e email-it apo ueb-faqja apo adresa/faqet tjera në rrjetet sociale.
 - 3.2.7 Personi i vdekur, testament lënësi dhe trashëgimtarët e tij/saj, dëshmitarët, të afërmit dhe të tjerët që kanë ndonjë lidhje me personin e vdekur.
 - 3.2.8 Ekspertët e gjykatës dhe përkthyesit, dhe dëshmitarët e gjykatës, përfshirë por jo vetëm dikush që ka lidhje me palën (familja, mik, etj.) punëtorët socialë, psikologët, arsimtarët, doktorët, etj.
 - 3.2.9 Komuna (përveç nëse qyteti apo komuna është palë në rast).
 - 3.2.10 Viktima, i dënuari, dëshmitari, dhe personat e tjerë të akuzuar por të liruar ose kundër të cilëve është refuzuar aktakuza.
 - 3.2.11 Ekspertët mjeko-ligjorë dhe ekspertët hetues.

Neni 4 **Te dhënat që nuk anonimizohen**

- 4.1 Të dhënat që përfshihen në aktgjykim e nuk i nënshtrohen anonimizimit janë:
- 4.1.1 Emri i gjykatës dhe emrat e gjykatësve,

- 4.1.2. Prokurorët,
- 4.1.3 Anëtarët e panelit gjyqësor, sekretaret juridike, bashkëpunëtorët profesionalë, përkthyesit, etj.,
- 4.1.4 Organet shtetërore dhe përfaqësuesit e tyre,
- 4.1.5 Numri dhe data e aktgjykimit,
- 4.1.6 Ndërmarrjet publike,
- 4.1.7 Emri dhe numri i regjistrimit të biznesit të personit juridik.

Neni 5

Mënyra e Zëvendësimit të të Dhënave të Anonimizuara

- 5.1 Emri dhe mbiemri i vërtetë zëvendësohen me iniciale, që përfshijnë një shkronjë të madhe dhe pikë.

Për shembull: Afrim Bujari = A.B.

- 5.2 Kur më shumë se një person kanë inicialet e njëjta, atëherë shtohet një numër pas inicialit të dytë.

Për shembull: Afrim Bujari = A.B.1; Astrit Bytyqi = A.B.2; Asllan Berisha = A.B.3

- 5.3 Adresat fshihen tërësisht, përveç komunës.

- 5.4 Adresa e e-mailit, ueb-faqes dhe rrjeteve sociale zëvendësohen me llojin e shërbimit të internetit, pasuar me tri pika.

Për shembull: xyz@yahoo.com := email...

Për shembull: www.google.com := www...

Për shembull: www.facebook.com/EROL := Facebook...

Për shembull: #PristinaArts = Twitter...

- 5.5 Numrat e letërnjoftimit, numrat e pasaportës, numrat e patentë shoferit, regjistrimi apo tabelat e veturës si dhe numrat e identifikuesit e tjerë të të Dhënave Personale anonimizohen duke përdorur një fjalë për llojin e dokumentit, pastaj tri pika.

Për shembull: Numri i Pasaportës 123456789 = Pasaporta...

Për shembull: Patentë shoferi X871Q92 – Patentëshoferi...

- 5.6 Data e lindjes anonimizohet duke e përdorur togfjalëshin ‘data e lindjes’ pastaj tri pika.

Për shembull: data e lindjes/ lindur me 01.01.1966 = Data e lindjes...

Neni 6

Publikimi i Aktgjykimeve

- 6.1 Aktgjykimi i Plotfuqishëm publikohet në ueb-faqen zyrtare brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita kur vendimi e merr formën e prerë, sipas këtij udhëzimit.
- 6.2 Vendimi i plotfuqishëm anonimizohet para publikimit.
- 6.3 Anonimizimi i aktgjykimit behet nga bashkëpunëtori profesional në secilën gjykatë dhe degë të saj i caktuar nga kryetari i gjykatës përkatëse.
- 6.4 Bashkëpunëtori profesional e përcjell aktgjykimin e anonimizuar tek zyrtari për informim publik pranë gjykatës apo stafit tjetër të autorizuar të gjykatës për ta vendosur aktgjykimin e plotfuqishëm në ueb-faqen e gjykatës në ueb-faqen zyrtare.
- 6.5 Zyrtari për informim publik apo stafi tjetër i autorizuar i gjykatës vendos aktgjykimin e plotfuqishëm në ueb-faqen zyrtare në formatin PDF. Zyrtari për informim publik apo stafi tjetër i autorizuar i gjykatës kompletton çfarëdo informate tjetër ashtu siç kërkohet nga shablloni i ueb-faqes zyrtare, përfshirë edhe por jo duke u kufizuar në emrin e gjyqtarit, gjykatës dhe datën e vendimit.
- 6.6 Kryetarët e gjykatave, gjyqtaret mbikëqyrës, administratorët dhe ndihmës administratorët rishikojnë rregullisht, së paku një herë në muaj, progresin e gjykatës rreth përmbushjes së kriterit për publikimin e aktgjykimeve të plotfuqishme brenda 60 ditëve.

Neni 7

Korrigjimi i publikimit të aktgjykimit

Me kërkesë të palës apo zyrtarisht mund të korrigjohet publikimi i aktgjykimit nga personi i cili urdhëron publikimin e aktgjykimit brenda afatit prej 7 ditësh nga njoftimi.

Neni 8

Përkthimi i aktgjykimit të publikuar

- 8.1 Aktgjykimet publikohen në gjuhen përpilimit të aktgjykimit.
- 8.2 Në qoftë se pala flet tjetër gjuhë zyrtare nga ajo ne te cilën është përpiluar aktgjykimi atëherë ai aktgjykim publikohet edhe në gjuhen që flet pala.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pasi të jetë miratuar nga Këshilli.

Prishtinë, _____, 2016



Enver Peci,

Kryesues,

Këshilli Gjyqësor i Kosovës